

Urdhër
Nr. 635, datë 5.11.2013

Për delegim kompetencash

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar

Urdhëroj:

- 1.Delegimin e kompetencave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, Z.Genci Gjonçaj.
 - 2.Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 11 tetor deri më 31 dhjetor 2013.
 - 3.Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
 - 4.Urdhri nr. 382, datë 31.12.2012 “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ministri
Saimir Tahiri

Urdhër
Nr. 636, datë 5.11.2013

Për delegim kompetencash

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), si dhe të pikës 12, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 21.5.2003 “Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri

Urdhëroj:

1. Autorizimi për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë;
 2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit;
 3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, të këtij urdhri;
 4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 254, datë 26.7.2012 “Për delegim kompetence” do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor;
 - 5.Për autorizimet e lëshuara ipas pikës 1 të këtij urdhri, do të gjejë zbatim ky i fundit;
 6. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, shfuqizohet.
 - 7.Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



Ministri
Saimir Tahiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2013

AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN CIVILE ME PALË:

Paditës:

E paditur:

Objekti:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, dhe të urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. , datë
"Për delegim kompetence",

VENDOSA:

Autorizimin e Z/Znj., me detyrë, për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin/rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor/në Gjykatën e Apelit/në Gjykatën e Lartë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GENCI GJONÇAJ



Fletorja Zyrtare
e Republikës së Shqipërisë
